



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 2.10.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Liburn Aliu, Salih Zyba.

Munguan: Etem Arifi, Lutfi Zharku, Srđan Mitrović.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 25.9.2018;
3. Miratimi në parim i dy projektligjeve;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.9.2018

Kryetari i komisionit konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25 shtator 2018.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe Pl për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryetari Muharrem Nitaj, ja dha fjalën **Salih Salihut** i cili në cilësinë e kryesuesit të GP informoi anëtarët e Komisionit që pas takimit të GP për miratim në parim apo jo të projektligjit për mbrojtjen e ajrit, grupi punues ka rekomanduar për miratim në parim pasi që ky projektligj i plotëson kushtet formale për procedim sipas Nenit 54 të rregullores së kuvendit.

Besa Gaxherri rreth projektligjit për ndryshim e plotësim të Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit ku ajo ishte kryesuese e GP për hartim, por edhe për projektligje tjera, përsëriti qëndrimin e partisë nga vjen që anëtarët e saj nëpër komisione nuk votojnë por në mbledhje plenare

paraqesin qëndrimin veç e veç. Megjithatë për projektligjin i cili tani ka marr edhe mendimin pozitiv nga qeveria, NP të Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit, njoftoi se hartimi është bërë në mënyrë shumë profesionale dhe është e gatshme për procedim të mëtejme ky projektligj. Përkundër vërejtjes së **Danush Ademit** se me ligjin paraprak kultet fetare kanë qenë të lira nga pagesa e ujit, ajo potencoi se ky fakt vlen për objektet përcjellëse jo për kulte, sido që të jetë ky ndërhyrje mund të shqyrtohet në GP pas leximit të parë. **Ganimete Musliu** sugjeroi të caktohet GP me Besa Gaxherrin kryesuese, por zj. Gaxherri tha se ka kohë për GP por edhe qëndrimi i partisë nga vjen për mosvotim nëpër komisione, deri tani është i pandryshueshëm.

Kryetari pas votimit për dy projektligje, konstatoi dërgimin e tyre në leximin e parë.

4. Te ndryshme

Kryetari Muharrem Nitaj hapi diskutimin nëse ka ndonjë çështje të ndryshme dhe pasi që z. **Salih Zyba** inicoi çështje nga plani i punës për sesionin vjeshtor ende të pa miratuar, fillimisht ftoi komisionin për të miratuar këtë plan me mundësi të plotësisht kohë pas kohe, çka edhe u veprua ashtu, **komisioni miratoi planin vjeshtor** me këto plotësime :

- Komisioni do të vazhdoi monitorimin e zbatimit të Ligjit për ndërtimet ku është caktuar kryesues **Liburn Aliu**, të shikohet Enver Hotin a do të zëvendësoi Etem Arifi apo ndonjë anëtarë tjetër,
- Vizita në kompleksin Adem Jashari caktohet për 8.10.2018, nisja në orën 10,00 nga Kuvendi, të ftohet drejtori i agjencisë z. Zogaj dhe kryetari i komunës Skenderaj si dhe të njoftohet familja Jashari, të sigurohet transporti për komisionin por edhe për Besa Gaxherrin nga Peja dhe anasjelltas,
- Nga MMPH të kërkohet raporti për zonën e Brezovicës rreth ndërtimeve që po bëhen janë apo jo në rregull sipas ligjit,
- Të vizitohet fshati Hade me rrethinë rreth çështjeve pronësore të cilat ende janë aktuale në procesin e eksproprijimit,
- Të raportohet fillimisht nga zyrtarët kompetent për çështjen e farërave dhe plehrave, të ftohen në komision zyrtarët nga AUV, pastaj të shikohet mundësia e organizimit të një tryeze me fermerë dhe zyrtar tjerë bujqësor për të formuar qëndrimin komisioni për veprime të mëtejme dhe për ligjin i cili vjen në kuvend gjatë muajit dhjetor 2018, të riaktualizohet çështja e prejardhjes së miellit dhe për çështjen e qumështit a ka përparime,
- Rreth shkatërrimit të pyjeve të ftohen zyrtarët edhe nga MMPH edhe MB të cilët do të njoftojnë komisionin për ndonjë risi rreth menaxhimit me parqe dhe pyje, gjithashtu MMPH të raportoj për deponitë nëpër Kosovë sa janë legale dhe sa janë eliminuar ato jolegale,
- Kompenzimi i dëmeve dhe shpërndarja e subvencioneve të sqarohet qartë nga MB duke ftuar në komision ministrin dhe kompetentët e ministrisë apo agjencisë për këto ndihma,
- Të vizitohet KEK rreth çështjes së ndotjes së ajrit, sa është arritur me ndërrimin e filterëve që mbrojnë ajrin,
- Për vizitën në komisionin homolog në Shqipëri, komisioni angazhoi **Salih Salihun** për angazhimin rreth realizimit dhe fillimisht shkresën e arsyetuar që do ti dërgohet komisionit homolog (kryetarit Eduard Shalsi).

Mbledhja përfundoi në orën 14,00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Muharrem Nitaj